



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	17.08.2026	31.08.2026	2026/0598
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
Gentiana Miftari	18.08.2026		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.08.2026, OE “FWRDZ L.L.C.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0598, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “FURNIZIM ME SPALETA RITENDER” me nr. të prokurimit: "214/30400-26-4777-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 119,459.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Pretendohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur këto dispozita:

Neni 7 i LPP-së - parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës.

Neni 59, veçanërisht paragrafi 2, i LPP-së - ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, përfshirë mundësinë e kërimit të sqarimeve për aspektet e tenderit pa ndryshuar aspektet materiale të tij.

Neni 38.1 dhe 38.4 i Rregullores për Prokurimin Publik - lidhur me sqarimin e tenderëve dhe qartësimin e deklaratave/certifikatave të paqarta.

Neni 40.2 i Rregullores për Prokurimin Publik - tenderët duhet të vlerësohen sipas kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara paraprakisht në Njoftimin për Kontratë/Dosjen e Tenderit dhe nuk lejohen kërkesa, kritere apo specifikime të reja gjatë vlerësimit.

Neni 40.12 i Rregullores për Prokurimin Publik - tenderuesi nuk duhet të diskualifikohet ose përjashtohet mbi bazën e një kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në Njoftimin për Kontratë/Dosjen e Tenderit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
		a) Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik- Certifikata Regjistrimit të Biznesit (nëse OE i jashtëm shpallet fitues duhet te regjistroj përfaqësinë ne Kosovë para nënshkrimit te kontratës)	a) Certifikata e Regjistrimit të Biznesit e leshuar nga Agjensioni per Regjistrimin e Bizneseve ne Ministrine e Tregtise dhe Industrise (kopje
		b) Certifikatën e TVSH-së (kopje) (për Operatorët Ekonomik vendor)	b) Certifikata e TVSH-se (për Operatorët Ekonomik vendor)
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj mostra për secilin artikull nga nje palë (2 cope) prej pozicionit 1 deri 13 sipas specifikacioneve teknike Aneksit 1, më së largu deri ditën e hapjes para orës 14 00.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmi 1 Mostrat duhen dorëzuar për secilin artikull (palë) më së largu deri ditën e hapjes para orës 14 00.
		Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj atestet të kryera për artikullin me numër 4 dhe 8 nga një Laborator i akredituar sipas specifikave teknike Aneksi 1.	Dëshmi 2 Dorëzimi i atesteve të kryera nga një Laborator i akredituar për artikullin me numër 4 dhe 8 sipas specifikave teknike të kërkuara.
		Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj mostrën me numra 5 shifrorë për spaletat me Grada Polic i Ri, Grada Polic, Grada Polic i Lartë (palë) sipas specifikacioneve teknike Aneksit 1, më së largu deri ditën e hapjes para orës 14 00 për artikulli me nr 2,3,4.	Dëshmi 3 Mostrat duhen dorëzuar me numra 5 shifrorë për spaletat me Grada Polic i Ri, Grada Polic, Grada Polic i Lartë (palë) për artikull 2,3,4 (palë) para datës së pranimit të ofertave ora 14 00.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria / Vlada / Government Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Ministry of Internal Affairs	
	Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate	

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: FURNIZIM ME SPALETA - RITENDER

Nr. i prokurimit ²	214/30400-26-4777-1-2-1
Nr i brendshëm	214/26/014/121

Nr.	Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1.	FWRDZ L.L.C	102,313.16 €
2.	Naim Shuki B.I.	97,797.00 €
3	AJANI & ADAMI SH.P.K	116,682.00 €
4	AR & BUS" SH.P.K	110,404.00 €
5	Hamiti Group SH.P.K	81,889.54 €
6	LOTUS GROUP " SH.P.K.,	105,264.46 €

Policia e Kosovës Anulon aktivitetin e prokurimit pasi nuk kemi asnjë ofertë të përgjegjshme.

Data:

29/07/2026

Emri dhe mbiemri i ZPP: Anton Fejza



¹ Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojës).

² Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - FWRDZ L.L.C.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me njoftimin mbi Vendimin (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit, të AK – Policia e Kosoves, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 të LPP-së.

Pas perfundimit të vleresimit të ofertave AK-Policia e Kosoves, e njofton OE ankues me letren standarde të tenderuesit te eliminuar, të cilin e eliminon me arsyetimin si më poshtë:

OE eshte I përgjegjshem per arsyet si ne vijim:
OE ka sjelle atestet te dates 28.10.2025, per nje aktivitet I cili eshte bere hapja me date 03.11.2025.
OE ne kete aktivitet eshte eliminuar per arsye te moseplotesimit te specifikacioneve teknike, Aneksit 1.
OE nuk ka bere attest per mostra te aktivitetin ne proces, andaj eshte deshmuar qe OE mostrat e sjella per kete aktivitet nuk I ka derguar fare per attest.
Andaj OE eshte I përgjegjshem dhe oferta I refuzohet.

Sa i perket arsyes se eliminimit, lidhur me daten e raportit të atesteve 28.10.2025, eksperti shqyrtues vlereson se nuk qendron ky arsyetim i autoritetit kontraktues, sepse autoriteti kontraktues konform dispozitave të nenit 72 dhe 59 të LPP-së, mund të kërkojë sqarime shtese nga lobaratori përkatës dhe për cdo dyshim tjetër mund të kërkojë nga operatori ekonomik ateste të reja.

Sa i përket mosplotesimit të specifikave teknike, përgjigjjet ne pretendimet ankimore teknike i ka dhene eksepri teknike:

1. Baza e autorizimit dhe objekti i ekspertizës

Me autorizimin e OSHP-së, Ref. 2026/0598, datë 18.08.2026, unë, Gentiana Miftari, jam caktuar eksperte teknike, në bashkëpunim me ekspertin shqyrtues Florije Rexhepi, për shqyrtimin e ankesës së Operatorit Ekonomik FWRDZ L.L.C. lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME SPALETA RITENDER”, nr. 214/30400-26-4777-1-2-1, të iniciuar nga Policia e Kosovës.

Në këtë raport kam shqyrtuar aspektet teknike të dokumentacionit relevant, kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Aneksit 1, raportet/atestet laboratorike të dorëzuara për artikujt nr. 4 dhe 8, si dhe konstatimet e mia nga ekzaminimi fizik i mostrave të FWRDZ L.L.C. Raporti im kufizohet në aspektet teknike; çështjet juridike të ngritura në ankesë i paraqes vetëm në masën e nevojshme për të kuptuar pretendimet.

2. Dokumentacioni i shqyrtuar

- Autorizimi i OSHP-së Ref. 2026/0598, datë 18.08.2026;
- Ankesa e FWRDZ L.L.C., datë 13.08.2026, dhe dokumentet përcjellëse;
- Dosja e Tenderit / Njoftimi për Kontratë dhe Aneksi 1 – Specifikacionet Teknike të Detyrueshme;
- Oferta dhe deklaratat e FWRDZ L.L.C., përfshirë deklaratën e prodhuesit dhe deklaratën për përmbushjen e specifikimeve teknike;
- Raportet laboratorike të PROFI LAB për artikullin nr. 4 – Grada Polic i Lartë dhe artikullin nr. 8 – Grada Major, të lëshuara më 28.10.2025;

- Lista/fushëveprimi i akreditimit të laboratorit PROFI LAB;
- Dokumentet e Autoritetit Kontraktues lidhur me vlerësimin/eliminimin dhe anulimin e aktivitetit;
- Mostrat fizike të FWRDZ L.L.C. të ekzaminuara në Policinë e Kosovës më 24.08.2026 dhe fotografitë e realizuara gjatë ekzaminimit.

3. Kërkesat teknike relevante të Dosjes së Tenderit

Te kapaciteti teknik dhe profesional, Dosja e Tenderit kërkon që OE të dorëzojë nga një palë (2 copë) mostra për secilin artikull nga pozicioni 1 deri 13 sipas Aneksit 1. Veçmas, Kërkesa 2 kërkon ateste të kryera për artikujt nr. 4 dhe 8 nga një laborator i akredituar sipas specifikimeve teknike të Aneksit 1. Për artikujt nr. 2, 3 dhe 4 kërkohej gjithashtu mostra me numra identifikues pesëshifrorë.

Aneksi 1 përcakton se materialet themelore, ngjyrat dhe materialet me të cilat punohen/qëndrisen spaletat duhet të dëshmohen me atestet laboratorike përkatëse. Për materialin themelor janë përcaktuar, ndër të tjera, përbërja PES 55% / WO 45%, ngjyra 19-3934, masa 200 g/m² (±5%), diametri i fibrës së leshit 21.5 µm, dendësia e fijeve, forca e thyerjes, rezistenca ndaj cuklave dhe pastrimit, stabiliteti dimensional dhe qëndrueshmëria e ngjyrës.

Për Gradën Major, Aneksi 1 përshkruan spaletë me ngjyrë të kaltër të mbyllur, shirit rrethues ngjyrë ari dhe një yll gjashtëcepësh të mbushur; dimensionet e përcaktuara përfshijnë gjatësinë qendrore 140 mm, gjatësinë jashtë thyerjes 110 mm, thyerjen 40 mm, gjerësinë 60/55 mm dhe yllin 17 mm. Për variantin solemn parashihet shirit rrethues 8 mm, ndërsa për variantin standard 4 mm.

4. Pretendimi teknik i ankuesit dhe çështja kontestuese

FWRDZ L.L.C. kundërshton vendimin e AK-së dhe, në aspektin teknik, argumenton se Dosja e Tenderit i trajton si kërkesa të ndara mostrat fizike dhe atestet laboratorike. Ankuesi pretendon se DT nuk ka përcaktuar datë skadence të atesteve, nuk ka kërkuar që raportet të lëshohen posaçërisht për ritenderin dhe nuk ka kërkuar që mostra fizike e dorëzuar në ritender të jetë e njëjta copë fizike mbi të cilën është kryer testimi laboratorik.

Ankuesi pretendon gjithashtu se materiali i përdorur në procedurën aktuale është i njëjtë me materialin e testuar dhe se ndryshimet kanë qenë vetëm në elemente vizuale. Në ankesë referohet edhe një sqarim i PROFI LAB lidhur me materialin dhe metodën e testimit. Këto i trajtoj në kuadër të dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi. Nga ekzaminimi fizik që kam kryer më 24.08.2026 nuk kam pasur mundësi të verifikoj në mënyrë të pavarur identitetin

teknik të materialit të vitit 2026 me materialin e testuar në vitin 2025, pasi mostrat e vitit 2025 nuk kanë qenë në dispozicion.

5. Shqyrtimi i raporteve laboratorike

Raporti laboratorik për Gradën Major raporton, ndër të tjera: përbërje PES 55% / WO 45%; masë 200 g/m²; diametër të fibrës së leshit 21.5 µm; WARP 35/cm dhe WEFT 19/cm; forcë thyerjeje WARP 110 daN dhe WEFT 55 daN; pilling 5 pas 18,000 dhe 36,000 cikleve; rezistencë në abrazion 25,000 cikle; stabilitet dimensional -1.5% / -1.5%; dhe vlera 5 për testet e qëndrueshmërisë së ngjyrës. Raporti për Gradën Polic i Lartë paraqet parametra të ngjashëm dhe përfundon se mostrat e testuara plotësojnë kërkesat teknike të referuara në raport.

Gjatë krahasimit dokumentar kam vërejtur se Aneksi 1 kërkon për masën standardin ISO 3801 Part III, ndërsa raporti për Gradën Major e paraqet ISO 12127. Për raportin e Gradës Polic i Lartë është paraqitur ISO 3801 Part III; në ankesë është paraqitur sqarimi se PROFI LAB e ka cilësuar këtë shënim si gabim administrativ dhe se gjatë testimit është përdorur EN ISO 12127:2014. Po ashtu, Aneksi 1 përmend BS 5811 për cuklat dhe BS 5690 për rezistencën në pastrim, ndërsa raportet përdorin EN ISO 12945-2 dhe EN ISO 12947-2. Në dokumentacionin e akreditimit të laboratorit gjenden metoda EN ISO 12945-2 dhe EN ISO 12947-2. Për qëllim të këtij raporti nuk i barazoj automatikisht standardet me emërtim të ndryshëm; nëse kjo çështje konsiderohet vendimtare, ekuivalenca duhet të mbështetet me sqarim teknik të dokumentuar nga laboratorit ose organi kompetent.

Gjithashtu, në tabelat e rezultateve të raporteve që kam shqyrtuar nuk kam evidentuar veçmas parametrin “Relaksimi në tkurrje SHIRLEY WARP/WEFT min. 155°”, i cili figuron në Aneksin 1. Për këtë arsye, vetëm nga këto tabela nuk mund të konkludoj se ky parametër specifik është dëshmuar.

6. Ekzaminimi fizik i mostrave – 24.08.2026

Më 24.08.2026, unë, Gentiana Miftari, në rolin e ekspertes teknike, së bashku me ekspertin shqyrtues Florije Rexhepi, kam bërë ekzaminimin fizik të mostrave të FWRDZ L.L.C. në Policinë e Kosovës. Mostrat e vitit 2025 nuk kanë qenë në dispozicion për krahasim me mostrat e ritenderit.

Gjatë së njëjtës vizite kam parë edhe mostrat e disa operatorëve të tjerë ekonomikë, vetëm me qëllim të krijimit të një reference krahasuese vizuale ndërmjet punimit të mostrave. Këto mostra nuk kanë qenë objekt i ekspertizës sime dhe nuk i kam përdorur si bazë për vlerësimin e përputhshmërisë së ofertës së FWRDZ L.L.C. me Dosjen e Tenderit. Vlerësimi dhe konstatimet e këtij raporti lidhur me mostrat fizike i referohen mostrave të FWRDZ L.L.C.

Gjatë ekzaminimit kam bërë vëzhgim vizual dhe matje orientuese të mostrave me metër tekstili, duke i krahasuar dimensionet e dukshme me kërkesat përkatëse të Aneksit 1. Matjet nuk janë regjistruar si seri e plotë e vlerave numerike për secilën mostër, prandaj në këtë raport nuk paraqes rezultate dimensionale të detajuara. Në punimin/qëndisjen e pjesës së artë kam vërejtur devijime të vogla në precizitet dhe simetri. Këtë e konsideroj vërejtje vizuale të punimit dhe, në mungesë të një tolerance të shprehur specifike për këtë element dhe të një evidentimi numerik të plotë të matjeve, nuk e trajtoj si provë të mjaftueshme për mospërputhje

teknike apo si bazë të pavarur për eliminim.

Nuk kam kryer testime laboratorike të materialit dhe nuk kam pasur mundësi të bëj krahasim fizik me mostrat e FWRDZ L.L.C. të vitit 2025. Në mostrat që kam ekzaminuar nuk kam evidentuar kod material, numër loti apo identifikues tjetër që të mundësonte një verifikim të drejtpërdrejtë të lidhjes me raportet laboratorike të datës 28.10.2025. Theksoj se një identifikues i tillë nuk është evidentuar nga unë si kërkesë e shprehur e DT-së; ky fakt paraqitet vetëm si kufizim i mundësisë sime për verifikim të pavarur. Për rrjedhojë, vetëm nga ekzaminimi vizual dhe matjet orientuese me metër tekstili nuk mund të vërtetoj dhe as të përjashtoj se materiali aktual është identik me materialin e testuar në vitin 2025.

7. Analiza teknike

7.1. Atesti i vitit 2025 dhe kërkesa për ritestim

Nga formulimi i Kërkesës 2/Dëshmisë 2 në DT nuk kam identifikuar një kërkesë të shprehur që atesti të jetë lëshuar pas publikimit të ritenderit, të ketë afat të caktuar skadence, të mbajë numrin e aktivitetit aktual ose që mostra tenderuese të jetë pikërisht e njëjta copë fizike e testuar në laborator. Aneksi 1 e lidh kërkesën për ateste me materialet themelore, ngjyrat dhe materialet e punimit/qëndisjes. Prandaj, nga këndvështrimi im teknik, data 28.10.2025 e raportit nuk provon vetvetiu se karakteristikat e materialit të raportuara nga laboratorin kanë ndryshuar.

Megjithatë, vetëm nga inspektimi fizik që kam kryer nuk mund të konfirmoj në mënyrë të pavarur se materiali i mostrave të vitit 2026 është i njëjtë me materialin e testuar në vitin 2025. Kjo është një kufizim i verifikimit tim teknik dhe jo konstatim se materiali është i ndryshëm apo se DT ka kërkuar domosdoshmërisht identifikues loti/gjurmueshmërie.

7.2. Përputhja e metodave dhe parametrave të testimit

Raportet laboratorike përmbajnë një numër të konsiderueshëm parametrash që numerikisht përputhen ose tejkalojnë vlerat e kërkuara në Aneksin 1. Megjithatë, për disa parametra emërtimi i metodës së testimit ndryshon nga standardi i shkruar në Aneksin 1. Pa një dëshmi të qartë të ekuivalencës së metodave, nuk mund t'i barazoj automatikisht standardet e ndryshme vetëm mbi bazën e rezultateve numerike.

7.3. Konstatimet vizuale

Devijimet e vogla që kam vërejtur në precizitetin/simetrinë e pjesës së artë i evidentoj si vërejtje vizuale. Nga dokumentacioni që kam shqyrtuar, matjet orientuese të kryera dhe ekzaminimi fizik, nuk kam siguruar bazë të mjaftueshme për t'i klasifikuar këto devijime si mospërputhje materiale me specifikimin teknik.

8. Përfundimi teknik

Në bazë të dokumentacionit që kam shqyrtuar dhe ekzaminimit fizik që kam kryer më 24.08.2026, vlerësoj se arsyeja që një atest laboratorik është lëshuar më 28.10.2025, në

vetvete, nuk është e mjaftueshme teknikisht për të konkluduar se materiali i ofruar në ritender nuk i plotëson karakteristikat e dëshmuara në atë raport. Dosja e Tenderit kërkon ateste për artikujt nr. 4 dhe 8 nga laborator i akredituar sipas Aneksit 1, por në tekstin e kërkesës që kam shqyrtuar nuk kam identifikuar kusht të shprehur për datën e lëshimit, ritestimin për çdo procedurë të re apo identitetin fizik të mostrës tenderuese me mostrën e konsumuar/testuar në laborator.

Në të njëjtën kohë, nga ekzaminimi fizik që kam kryer nuk mund të konfirmoj në mënyrë të pavarur se materiali i mostrave të dorëzuara në vitin 2026 është identik me materialin e testuar në vitin 2025. Mostrat e vitit 2025 nuk ishin në dispozicion. Për këtë arsye, vetëm inspektimi vizual dhe matjet orientuese nuk janë të mjaftueshme për të provuar apo përjashtuar identitetin e materialit. Ky kufizim nuk duhet interpretuar si konstatim i mospërputhjes së materialit.

Po ashtu, kam evidentuar dallime ndërmjet disa metodave të emërtuara në Aneksin 1 dhe metodave të shënuara në raportet laboratorike, si dhe mungesë të evidentimit të veçantë të parametrit “Relaksimi në tkurrje SHIRLEY” në tabelat e rezultateve që kam shqyrtuar. Këto çështje i konsideroj të ndara nga çështja e datës së atestit dhe, nëse janë vendimtare për vlerësimin e përgjegjshmërisë së tenderit, vlerësoj se kërkojnë sqarim teknik të dokumentuar nga laborator/organ kompetent mbi metodën, ekuivalencën dhe gjurmueshmërinë e materialit.

9. Mendimi i ekspertit teknik

Në aspektin strikt teknik, vlerësoj se pretendimi i ankuesit është i bazuar në pjesën ku kundërshton papranueshmërinë e atesteve vetëm për shkak të datës së tyre ose për shkak se mostra aktuale nuk është e njëjta copë fizike e testuar, pasi në kërkesën teknike të DT-së që kam shqyrtuar nuk kam identifikuar një kusht të tillë të shprehur. Njëkohësisht, nga inspektimi im fizik nuk mund të jap konfirmim të pavarur laboratorik për identitetin e materialit 2025–2026. Dallimet në emërtimin e disa metodave të testimit dhe parametri SHIRLEY i evidentuar më sipër duhet të trajtohen si çështje teknike të veçanta dhe jo të përdoren si zëvendësim i arsyes së dhënë për refuzimin vetëm mbi bazën e datës së atestit.

Për rrjedhojë, rekomandoj që në vlerësimin e mëtejshëm të bëhet dallim ndërmjet: (i) pranueshmërisë së atestit në raport me kërkesën e shkruar të DT-së dhe mungesës së një kushti të shprehur për datën/ritestimin; (ii) asaj që mund të verifikohet nga inspektimi fizik i mostrës; dhe (iii) përputhjes së metodave/parametrave laboratorikë me Aneksin 1. Nga këndvështrimi im teknik, këto janë çështje të dallueshme dhe duhet të vlerësohen mbi bazën e dokumenteve dhe kërkesave përkatëse.

10. Kufizimet e ekspertizës

- Nuk kam kryer testime të reja laboratorike;
- Gjatë vizitës së 24.08.2026 kam kryer matje orientuese me metër tekstili, por nuk kam regjistruar një seri të plotë të vlerave numerike për secilën mostër dhe matjet nuk janë kryer me instrument laboratorik të kalibruar;
- Nuk kam pasur në dispozicion mostrat e FWRDZ L.L.C. nga procedura e vitit 2025 për krahasim;
- Nuk kam evidentuar kod/lot/identifikues në mostrat aktuale që të mundësonte verifikim

të drejtpërdrejtë me raportet T102557-1/T102557-2; këtë e paraqes si kufizim të verifikimit tim dhe jo si kërkesë shtesë të DT-së;

· Për vlerësimin e ekuivalencës normative ndërmjet standardeve të ndryshme të testimit mbështetem në nevojën për dëshmi/sqarim nga organ kompetent ose laborator i akredituar.

MENDIMI PËRFUNDIMTAR DHE REKOMANDIMI

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të lëndës, pretendimeve ankimore, kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe Aneksit 1, si dhe pas ekzaminimit fizik të mostrave, mendimi im përfundimtar në cilësinë e ekspertës teknike është që ankesa e Operatorit Ekonomik FWRDZ L.L.C. të aprovohet në pjesën e pretendimeve teknike të shqyrtuara dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Ky mendim mbështetet në faktin se nga kërkesat e shqyrtuara të Dosjes së Tenderit nuk rezulton të jetë përcaktuar shprehimisht që atestet laboratorike duhet të jenë të lëshuara pas inicimit të aktivitetit aktual të prokurimit, të kenë një afat të caktuar vlefshmërie apo që mostra fizike e dorëzuar në këtë procedurë duhet domosdoshmërisht të rritetohet. Për rrjedhojë, vetëm fakti që atestet laboratorike janë të datës 28.10.2025 nuk paraqet, nga aspekti teknik dhe bazuar në kërkesat e shqyrtuara të Dosjes së Tenderit, bazë të mjaftueshme për refuzimin e tyre.

Megjithatë, ky përfundim nuk nënkupton konstatim se materiali i mostrave të vitit 2026 është provuar laboratorikisht si identik me materialin e testuar në vitin 2025. Gjatë ekzaminimit fizik nuk kam pasur në dispozicion mostrat e vitit 2025 për një krahasim të tillë dhe kjo çështje nuk mund të vërtetohet vetëm përmes ekzaminimit vizual.

Prandaj, rekomandimi im përfundimtar është: APROVOHET ANKESA në pjesën e pretendimeve teknike të shqyrtuara dhe LËNDA KTHET NË RIVLERËSIM.

SHTOJCA 1 – DOKUMENTIM FOTOGRAFIK NGA EKZAMINIMI FIZIK

Fotografitë e mëposhtme janë realizuar gjatë ekzaminimit fizik të datës 24.08.2026 dhe paraqesin mostrat e FWRDZ L.L.C. të shqyrtuara në Policinë e Kosovës. Ato shërbejnë si dokumentim vizual plotësues i konstatimeve të përshkruara në raport.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “FWRDZ L.L.C.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME SPALETA RITENDER” me numër të prokurimit: “214/30400-26-4777-1-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS



Foto 1. Pamje e përgjithshme e mostrave të FWRDZ L.L.C. gjatë ekzaminimit fizik.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “FWRDZ L.L.C.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME SPALETA RITENDER” me numër të prokurimit: “214/30400-26-4777-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS



Foto 2. Detaj i pjesës së artë/qëndisjes së mostrave të FWRDZ L.L.C., e shqyrtuar vizualisht për precizitet dhe simetri.



Foto 3. Pamje e përgjithshme shtesë e mostrave të FWRDZ L.L.C. gjatë ekzaminimit fizik.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **FWRDZ L.L.C.**



Florije Rexhepi

Gentiana Miftari